

## Protokoll

I mbajtur sot me datë 30.09.2024, ora 10:30 në sallën e mbledhjeve të Këshillit të bashkisë me këtë renditje të ditë:

1. Miratimi i Projekt Vendimit për listën e përfunduar të ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuar të ndihmës ekonomike të 6% për muajin Gusht 2024.

2. Miratimi i Projekt Vendimit për kalendarin e konsultave Publik për buxhetin afatmesëm 2025-2027.

3. Raporti i Monitorimit për katër muajorin e dytë të vitit 2024.

4. Miratimi i Projekt Vendimit për Nivelin e pagave dhe disa ndryshime në VLB nr.34 dt.29.12.2023.

5. Miratimi i Projekt Vendimit "Për ndarjen dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar të Emergjencave Civile për ndërhyrjen emergjente në rikonstruksionin e rrugës auto të fshatit Dardhë, Njësia Administrative Dardhë, rikonstruksionin e murit mbajtës pranë Çerdhes së fëmijëve Fushë-Arrëz si dhe blerje paisjesh për MZSH".

6. Miratimi i Projekt Vendimit "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e bordit të kopshteve në arsimin parashkollor".

7. Miratimi i kërkesës për lirimin nga detyra të Sekretarit aktual të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz.

8. zgjedhja e Sekretarit të ri të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz.

9. Rishqyrtimi i vendimeve të kthyer nga Prefekti e Qarkut.

10. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve.

institucionere, etj.



Në mbledhje marrin pjesë: Kryetari i Bashkisë Z. A. Përgjegjësja e Çështjeve Sociale Z. Fritete Arifaj, Përgjegjësja e Çështjeve Civile Z. Dod Pepa, Përgjegjësi i sektorit të Emergjencave Milla, Sekretari i Këshillit Z. Tom Curri, Mënkryetari i Bashkisë Z. Mikel Qafa, si dhe këshilltarët:

1. Besjana Marku
2. Franc Doda
3. Bardhak Qafa
4. Valentina Lleshaj
5. Lezina Ceca
6. Mustaf Pashkaj
7. Lin Prendi
8. Valentin Doçi
9. Afrim Ndoj
10. Nikolin Bardhoku

Mbledhjen e hap kryetari i Këshillit, i cili lexon rendin e ditës dhe hidhet në votim: 10 vota pro  
0 vota kundër  
0 vota abstenim.

Miratohet rendi i ditës së mbledhjes së datës 30.09.2024.

Pika 1.

Arifaj -> komisioni e ka kaluar. Shpjegon projektin hidhet në votim dhe votohet me 10 vota pro  
0 vota kundër  
0 vota abstenim

Miratohet pika 1 e rendit të ditës.

Pika 2.

T. Curri -> Menduam që ta fillojmë që tani, që mos të sforcohemi. Konsultimin e realizon vetëm Këshilli, ku bashkëpunon me zyret e Bashkisë, me publikun, etj.

Hidhet në votim : 10 vota pro  
0 vota kundër.  
0 vota abstënim

Miratohet pika 2 e rendit të ditës.

Pika 3.

D. Lika → Është detyrim ligjor që të paraqitet shtet  
katër muaj. Ky është raporti i u mujorit të dytë.  
Realizimi është më i lartë se vitet e tjera, shprehja  
që vitin tjetër të jetë 100%. Nuk kemi asnjë detyrim  
M. Qafa → kanë shumë që kanë detyrime, por që  
ju përgjigjen shkresave që iu dërgojme, ato janë të  
shkruara dhe nuk i ndryshojme dot, sepse kështu duhet

Pika 4.

D. Lika → Është ndryshuar niv. e pagave për pushtet  
vëndor. Ne jemi si Bashki me nën 50 mijë banorë  
jemi në nivelin maksimal të lejueshëm. Vkm 30 persona kanë

A. Ndoj → ku është performanca? Sa është performanca

N. Bardhokaj → Duhet të jetë një person, që të ketë performancën,  
ta pasqyrojë atë. Të jetë ndonjë i Zyrës së

D. Lika → janë 30 persona që plotësojnë kriteret ligjorë  
si arsimit të lartë, dhe janë klasifikuar sipas VKM-së

vendosur nga këshilli i Ministrave, nuk ka shpresa për të

N. Bardhokaj → Bashkitë e forta kemi diskutuar  
kemi zyrën e performancës. Me këto paga që kanë

punuar ka qenë e pamundur të kemi punëtorë,  
kemi më të thjeshtë për të pasur më shumë të

pranë mesh. Deri tani paga mesatare ka qenë 400

Hidhet në votim dhe votohet : 10 vota pro  
0 vota kundër  
0 abstënim.

Miratohet Pika 4 e rendit të ditës.

Pika 5.

Do të kërkojnë lidhje me pikën 4, janë shprehëtarë në dy struktura buxhetore.

N. Bardhi: Numri i punonjësve bëhet 304, ato që janë te pika 4 do të kalojnë, të dyja këto vendime lidhen bashkë.

Hidhet në votim dhe votohet me 10 vota pro  
0 vota kundër  
0 vota abstenim

Miratohet pika 5 e rendit të ditës.

Pika 6.

D. Pepa → Janë 28 milion lekë pa shfrytëzuar dhe vendosëm që 1 milion të shkojnë në devijimin e rrugës në Dardhë. Do devijohet tek 100 e disa metër. Tek

Çerdhja po shembet muri mbajtës ku është i amortizuar si shkak i lagështirës dhe përbën rrezik janë edhe 800 e ca mijë lekë fond për blerjen e disa uniformave dhe mjete pune për MZSH-në.

Hidhet në votim dhe votohet me 10 vota pro  
0 vota kundër  
0 vota abstenim.

Miratohet pika 6 e rendit të ditës.

Pika 7.

A. Enjielli → Duhet të krijohet një bord, me bashkëpunimin tuaj do të realizojmë. Do të bëjmë edhe për Njësitë, por duhet të bëjmë dy ose tri shtetrinjë gjeografike është e madhe dhe s'është të përballohen. Duhet të ngrihet një strukturë. Përcjella të ngrihet në qendër, pastaj në Njësi.

N. Bardhoku → Jam dakort që të ngrihet një rregullore dhe jam shumë dakort për ngritjen e...

A. Ndoj → Të jetë një bord me më shumë anëtarë ku të ketë përfaqësues të njëjve, por edhe prindër.

N. Bardhoku → Parashkollari është funksion i deleguar.

Elnini → Është detyrim ligjor, 15 ditë pas fillimit të shkollës krijohet bordi. Të bëhet një bord për secilin njësi, pasi harta territoriale është e papërballeshme.

B. Marku → Nuk është e arsyeshme të bëhet çdo njësi çdo bord. Është e vështirë sepse bordi ka specialist

assimi dhe sdo ketë çdo bord specialist. Është e papërballeshme, për mendimin tim. Veproni sipas ligjit.

Hidhet në votim për rregulloren dhe krijim e një bordi dhe votohet me: 10 vota pro  
0 vota kundër  
0 vota abstenim.

Miratohet Pika 7 e rendit të ditës.  
Pika 8.

N. Bardhoku → kemi një kërkesë për dorëheqje të Sekretarit Z. Tom Curri. Të falenderojmë për punën e pastër dhe të madhe që ke bërë. kemi nevojë për mbështetje në vazhdim.

Hidhet në votim: 10 vota pro  
0 vota kundër  
0 vota abstenim.

Miratohet kërkesa për lirimin e pozicionit të Sekretarit.

Pika 9

N. Bardhoku → Lexon kriteret që duhet të ketë kandidati për sekretar këshill. Është ligji: 139/205.

Kemi një kërkesë nga Naze Selimaj. E çertifikuar disa herë në trajnime të ndryshme, Mësuese Matematike për disa vite. Propozimi i dytë është Specialistja e Këshillit Z. Milla Ngrihet komisioni: Lin Prendi, Afrim, Mustafa

Hidhet në votim: 10 vota pro  
0 vota kundër  
0 vota abstënim.

Miratohet ngritja e komisionit për zgjedhjen e Sekretarit. Ngrihet komisioni dhe vazhdon votimi për dy kandidatët. Behet votimi dhe 8 vota janë për Naze Selimin, 1 për Valbona Millën dhe 1 abstënim. kalohet dhe miratohet vendimi për zgjedhjen e Sekretarës së re të Këshillit të Bashkisë Z. Naze Selimaj

Mban fjalim falenderues kandidatja dhe fituesja Z. Naze Selimi, e cila merr dhe urimet nga Këshilli

Mbledhja mbyllet!

Nikolin Bardhoku

Bardhok Zafa

Lezina Ceca

Franc Doda

Mustaf Pashkaj

Besjana Marku

Afrim Ndoj

Valentina Lleshaj

Valentin Doci

Lin Prendi

Sekretari

Tom Curri

Mbajti Protokollin

Valbona Milla

*[Signature]*